

**ANDUANA SHAHINI (KËRTALLI)****QËNDRIMI I SHTYPIT SHQIPTAR MBI PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË KONFERENCËN E PARË BALLKANIKE**

Konferencat Ballkanike (1930-1934) janë një nga ngjarjet më të rëndësishme, jo vetëm në politikën e jashtme të shtetit shqiptar, por edhe të rajonit të Ballkanit. Studiuesit shqiptarë, si: prof. Gazmend Shpuza<sup>1</sup>, prof. Paskal Milo<sup>2</sup> dhe Ilir Ushtelenca<sup>3</sup>, në studimet e tyre i janë referuar fenomenit në tërësi duke prekur shumë pak qëndrimin e shtypit mbi këto ngjarje. Botimi “Historia e Popullit Shqiptar”<sup>4</sup>, vëll.III i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Tiranë 2007) e ka trajtuar këtë ngjarje dhe për këtë arsye shërben si një nga burimet bazë të të dhënave zyrtare. Historia e Konferencave Ballkanike filloi si një nismë e Jugosllavisë dhe Greqisë e më pas përfshiu edhe vende të tjera, si: Shqipëria, Bullgaria, Turqia e Rumania. Ideja e krijimit të Konfederatës Ballkanike u ngrit mbi baza jo të qëndrueshme, sepse shtetet pjesëmarrëse patën konflikte mes tyre, e sheshimi dukej tepër i vështirë. Përgjithësisht, sipas studiuesve amerikanë, aspekti politik krijoi problemet e mosmarrëveshjet më të mëdha për ballkanasit.<sup>5</sup>

Qëllimi i këtij punimi është të sjellë qëndrimin e shtypit shqiptar të kohës mbi këtë fenomen të viteve '30, shek. XX. Përmes analizës që i është bërë artikujve të hartuar në gazeta të kohës hidhet dritë mbi disa qëndrime sa inkurajuese po aq edhe mosbesuese mbi këto Konferenca. Specifikisht, artikulli paraqet qëndrimin dhe pikëpamjet e gazetave të përditshme, javore apo revistave me karakter politik, të cilat botoheshin

<sup>1</sup> Gazmend Shpuza, *Shqipëria ndërmjet Ballkaneve e Apenineve*, Tiranë: Ekstra 1999.

<sup>2</sup> Paskal Milo, “Shqipëria dhe Aleanca Ballkanike”, *Studime Albanologjike*, nr.1, Tiranë: 1997, f. 53.

<sup>3</sup> Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e mbretit Zog*, Tiranë: Ermir 1997, f.260.

<sup>4</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena 2007, f.308.

<sup>5</sup> Robert J. Kerner, Harry N. Howard, *The Balkan Conferences and the Balkan Entente 1930-1935*, USA: Greenwood Press: 1970, f. 31-39; Theodore I. Geshkoff, *Balkan Union, A Road to Peace In Southeastern Europe*, New York: Morningside Heights, Columbia University Press, 1940.

brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Titujt kryesorë të marrë në shqyrtim janë: “*Vullneti i popullit*”, “*Rilindja e Arbënisë*”, “*Gazeta e Korçës*”, “*Ora*”, “*Gazeta shqipëtare*” dhe “*Dielli*” për periudhën që numrat e saj vinin në Shqipëri. Fillimisht u studiua mënyra se si periodikët e sipërpërmendur e interpretojnë lajmin dhe pastaj mënyra se si evoluon dhënia e këtij informacioni edhe brenda të njëjtës gazetë, pra, është realizuar një vështrim krahasues ndërmjet shkrimeve të gazetave të ndryshme dhe shkrimeve brenda së njëjtës gazetë. Duke shqyrtuar materialet në këtë aspekt, arrihet në disa të dhëna interesante mbi shkallën e civilizimit të shoqërisë shqiptare. Përmes trajtimit analitik të artikujve mbi Konferencën e Parë Ballkanike, konkludohet mbi qëndrimet politike që kishin krijuar figurat më të njohura të kohës, Pandeli Evangjeli, Mehmet Konica, At Gjergj Fishta etj.

Në thelb, Konferencat Ballkanike prezantojnë një përpjekje të popujve të Ballkanit për të unifikuar me njëri – tjetrin disa perspektiva të reja, me një synim madhor, krijimin e Federatës Ballkanike.<sup>6</sup> Përgjithësisht, nën ndikimin e planit të Briandit<sup>7</sup>, ministrit të Jashtëm të Francës, që synoi të bashkonte Evropën përgjatë viteve të krizës së madhe ekonomike botërore, edhe ballkanasit u munduan të realizonin një nismë të tillë. Pothuajse nën të njëjtin format organizimi, por edhe qëllimi, u zyrtarizua në vendet ballkanike dhe në Shqipëri, çelja e Konferencës së Parë Ballkanike, në vitin 1930. Shtypi në këtë periudhë ende manifestonte idetë e planit të Briandit.<sup>8</sup> Shpeshherë, në artikuj të ndryshëm dallohen paralelizma ndërmjet këtyre dy nismave me natyrë të njëjtë të cilat realizohen pothuajse në të njëjtën periudhë por aplikohen në rajone të ndryshme.

Si fenomen historik, kjo ngjarje është me interes pasi tregon se, për herë të parë popujt e Ballkanit e përcollën mes tyre seriozisht iniciativën e bashkimit. Historiku i nismave të tilla është i hershëm sepse që në antikitet ideja për bashkim ndërmjet ballkanasve shfaqet në formën e *Federalizmit* dhe *Imerializmit*<sup>9</sup>. Evolucionin e kësaj ideje, deri në periudhën e fundit të sundimit të Perandorisë Osmane, shek. XVIII, mori

<sup>6</sup> Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Tiranë: Toena, 2013, f.814.

<sup>7</sup> G. Shpuza, *Shqipëria ndërmjet Ballkaneve ...*, f.22.

<sup>8</sup> Gazmend Shpuza, “Qëndrimi i qeverisë shqiptare ndaj planit Briand”, në *Studime historike*, nr.1-4, Tiranë: 1994, f.83-84.

<sup>9</sup> Th. I. Geshkoff, *Balkan Union, A Road to Peace ...*, f.5.

një trajtë të re, ndërmjet Federalizmit dhe Nacionalizmit.<sup>10</sup> Më i dukshëm ky bashkëpunim shfaqet pas viteve 1900 në Ballkanin postoman me “*Lidhjen Ballkanike*” si një tentativë e konsoliduar për integrim ballkanik. Në vitet e Luftërave Ballkanike aktorët kryesorë të politikave ballkanike, me përjashtim të Shqipërisë, tentuan të krijonin përmes traktateve respektive një tjetër lidhje ndërmjet tyre. Shqiptarët mbetën jashtë si pasojë e “*besnikërisë së tyre ndaj Portës së Lartë*”,<sup>11</sup> arsye kjo që është përdorur më shumë se një herë kundra saj.

Pra, pavarësisht se problematika e viteve 1930, më shumë, i largoi popujt ballkanas sesa i bashkoi ato, veprimtaria e Konferencave nuk u ndal përgjatë viteve 1930-1934. Në kuadrin e saj pjesëmarrja ishte e gjerë, delegacionet mund të shprehnin mendimin e tyre dhe kishin të drejtën e votës në lidhje me vendimet. Çdo shtet pjesëmarrës nuk do të përfaqësohej zyrtarisht dhe qysh këtu qeveritë çliroheshin nga vendimet e “papëlqyeshme” që do të merreshin në Konferencë. Fuqitë e Mëdha i sheshuan qëndrimet e tyre, Britania me politikën e saj “pacifiste” i shfrytëzoi të gjitha energjitë në favor të qetësisë në Ballkan<sup>12</sup>. Italia insistoi në favor të ndërhyrjes së saj në rajon, por ekuilibrohej nga kundërshtitë e Jugosllavisë, e cila nga ana tjetër kishte bekimin e Francës.<sup>13</sup>

Shtypi, përveçse realizonte procesin e informimit publik ka qenë dhe është shumë i rëndësishëm për të kuptuar se si perceptohej nga fraksione të ndryshme politike dhe shoqërore nisma për bashkimin ballkanik. Në vitet ‘30 të shek. XIX, misioni i shtypit ishte i njëjtë: informimi i publikut dhe përcjellja e mesazheve sociale dhe politike sipas analizave të caktuara në përputhje me këndvështrimin që ndjek çdo e përditshme.

Lajmi mbi organizimin e Konferencës së Parë Ballkanike zuri një vend parësor në çdo të përditshme shqiptare, përgjatë periudhës korrik-dhjetor, 1930. Konferenca përfaqësoi një mbledhje të delegatëve nga çdo vend me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për bashkëpunim. Fuqitë kryesore ballkanike do të evidentonin, përmes

<sup>10</sup> *Po aty*, f.19.

<sup>11</sup> Arben Puto, *Pavarësia e shqiptarëve dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, Tiranë: 1967, f.451.

<sup>12</sup> Vuk Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë ndërmjet dy luftërave botërore” në *Gjurmime Albanologjike*, Prishtinë: 1968, f.222.

<sup>13</sup> Emine Bakalli, *Pakti Ballkanik dhe Shqipëria*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1996, f.12.

përfaqësuesve të tyre, fillimisht çështjet konfliktuale që largonin vendet me shpresën se vetëm kështu do të krijohesh mundësia e gjetjes së rrugëve për zgjidhjen e këtyre situatave.

Veçanërisht, një jehonë të madhe kësaj ngjarje i kanë kushtuar gazeta “Vullneti i popullit”, e cila pati ndikime qeveritare dhe “Rilindja e Arbënisë”, e cila përfaqësonte një organ të pavarur. Në tërësinë e artikujve të tyre me tematikë mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e Parë Ballkanike dhe pritshmëritë prej saj, u publikuan në vija të përgjithshme disa arsye:

*Së pari*, ishte një nga ngjarjet e rajonit në të cilën Shqipëria ftohej zyrtarisht të merrte pjesë, duke krijuar përshtypjen e përgjithshme të një vlerësimi të shtetit shqiptar;

*Së dyti*, ishte një ngjarje politike dhe, duke qenë e tillë, linte hapësira për analiza, interpretime, mbështetje apo qëndrime skeptike;

*Së treti*, pjesëmarrja e vendeve të tjera ballkanike në këtë nismë, krijonte fillimisht përshtypjen e një Locarno-je ballkanike, në të cilën shprehonin aq shumë ballkanasit e aq më tepër populli shqiptar;

*Së katërti*, qeveria shqiptare u angazhua në krijimin e komisionit që do të përfaqësonte Shqipërinë në Konferencën e Parë Ballkanike. Pjesëmarrja e figurave të njohura, si: Mehmet Konica, At Gjergj Fishta, Mit’hat Frashëri etj., nuk mund të mos tërhiqnin vëmendjen e shtypit. Për këtë, e përditshmja “Vullneti i popullit” shkruan se “*Qeveria nuk do të ketë pranë konferencës përfaqësues zyrtarë, sikundër nuk do të kenë edhe qeveritë e tjera të Ballkanit*”<sup>14</sup>, duke informuar njëkohësisht edhe popullin mbi karakterin jozyrtar të Konferencës. Po e njëjta e përditshme do të pranojë dy ditë më vonë, më 2 gusht 1930, se në Ministrinë e Punëve të Jashtme ishte mbledhur komisioni organizues i shoqatës shqiptare për Lidhjen e Kombeve, e cila do të krijojonte komisionin përkatës. Sipas shkrimit “*...nga bashkia e Shkodrës është vendosur At Gjergj Fishta dhe ajo e kryeqytetit përfaqësohet nga Mehmet Konica*”.<sup>15</sup> Shpeshherë në faqet e gazetave gjejmë edhe artikuj analizues mbi formimin politik apo profesional të këtyre personaliteteve, në lidhje me faktin se sa efektiv mund të ishin ato në mbrojtjen e interesave kombëtarë. Nuk mungojnë as thirrjet dhe lutjet e shumta publike që

<sup>14</sup> “Qeveria Shqiptare nuk do të dërgojë përfaqësues zyrtarë në Konferencën Ballkanike” në *Vullneti i popullit*, Tiranë, nr. 94, 31 korrik 1930, f.3.

<sup>15</sup> “Konferenca ndërballkanike, populli shqiptarë do të përfaqësohet prej së paku dhjetë vetë” në *Vullneti i popullit* nr. 96, 2 gusht 1930, f. 4.

gazetat i bënin qeverisë dhe komisionit në lidhje me përfaqësimin sa më dinjitoz të Shqipërisë në Konferencën e Parë Ballkanike. Pritshmëritë e tyre në këtë aspekt ishin të dukshme. Në lidhje me mënyrën se si u formua delegacioni, në shtypin e kohës nuk ka informacione<sup>16</sup> por në Arkivin Qendror Shtetëror (AQSH) ndodhet një vendim në të cilin shënohen emrat e delegatëve pa cilësuar kriteret e përzgjedhjes së tyre. Për mënyrën se si u përzgjedh delegacioni, deputeti Fejzi Alizoti paraqiti në Parlamentin e Shqipërisë një mocion rreth Konferencës së Parë Ballkanike. Ai kërkoi shpjegime rreth karakterit politik, ekonomik dhe social të saj, si dhe “*në lidhje me delegacionin, si u formua dhe në emër të kujt veproi ai...*”<sup>17</sup>. Të njëjtën kërkesë ai e përsëriti edhe rreth dy javë më vonë përsëri në parlament, por pa marrë përgjigje. Veprimin e deputetit F. Alizoti, gazeta “Vullneti i popullit” e komentoi si të pakuptimtë, pasi jo vetëm delegacioni por edhe Konferenca kishte karakter jozyrtar.<sup>18</sup> Por, po të analizojmë karrierën e kryetarit të delegacionit, nuk mund të mos mendojmë interesin e qeverisë shqiptare për Konferencën. Mehmet Konica ishte një diplomat i mirënjohur që nga vitet e Shpalljes së Pavarësisë, politikan i angazhuar në çështje mjaft të nxehta të kufijve në jug të Shqipërisë, pjesëmarrës në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, ministër i Punëve të Jashtme gjatë qeverisë së Durrësit, diplomat i Shqipërisë në Britani dhe për shumë vite si ndihmës dhe këshilltar i Mbretit Zog për çështjet e politikës së jashtme. Qëndrimi i artikullit kundërshtues ndaj mocionit të deputetit Alizoti, pati ngjyrimë të theksuara pro qeveritare.

“Vullneti i popullit” ishte një gazetë e përditshme e kryeqytetit, e cila përgjithësisht kishte ndikime qeveritare. Ajo përfaqësonte interesat e caktuara të qarqeve politike në qeveri dhe pikërisht për këtë arsye nuk gjejmë në të qëndrime skeptike mbi qëllimin e Konferencës, delegacionin që u formua, qëndrimin e mbajtur në Konferencë etj. Aktiviteti i saj shfaqet dukshëm në vitin 1931 me artikuj që vlerësonin veprimtarinë e komisioneve të krijuara për Konferencën e Parë Ballkanike në aspektin

<sup>16</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 151, viti (më tej: V.) 1930, fl.30, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.622 dt. 23 korrik 1930.

<sup>17</sup> “Kronika e kryeqytetit – Bisedimet në parlament” në *Gazeta Shqiptare*, Bari, 31 tetor 1930, f.1.

<sup>18</sup> *Vullneti i popullit*, 12 nëntor 1930, nr.177, f.1.

ekonomik (doganor), bujqësor, intelektual dhe shëndetësor<sup>19</sup>. Përgjithësisht, kjo e përditshme nuk i kushtoi rëndësi të drejtpërdrejtë çështjes së minoriteteve. Shpërqëndrimi i vëmendjes nga kjo çështje u bë përmes lartësimit të aspektit sociokulturor dhe ekonomik të konferencës.

Gjatë muajit gusht të vitit 1930 në kryeartikujt e të përditshmeve “Arbënia” dhe “Gazeta shqipëtare” gjejmë lajme dhe njoftime mbi Konferencën e Parë Ballkanike. Një analizë të gjatë mbi idenë dhe organizimin e Konferencës së Parë Ballkanike e gjejmë në artikullin “Kongresi Pan-ballkanik i Athinës”<sup>20</sup> ku fillimisht trajtohet ideja e Papanastasiut mbi funksionimin e Konferencës dhe pasojat që do të kishte ajo në rajon. Në këtë artikull gjejmë shumë detaje mbi funksionimin dhe programin e Konferencës, por edhe në këtë të përjavshme përjashtohet trajtimi politik i evenimentit, duke i dhënë rëndësi ekspozitës së artit tradicional ballkanas, dhe vizitës private që Mehmet Konica i kishte bërë këtij panairi. Përgjithësisht, artikulli pranon se ka gjasa të një bashkëpunimi ndërballkanik në disa aspekte të veçanta, si posta, telekomunikacioni, arti, kultura, dhe universitetet. Ende nuk ndihet tendenca e trajtimit të çështjes themelore, asaj të minoriteteve të Shqipërisë.

Përsëri në të përjavshmen, “Arbënia”, e cila përfaqësoi polin nacionalist që studioi dhe vlerësoi ngjarjet në favor të Shqipërisë, gjejmë artikullin “*Shqipëria pranë Lidhjes së Kombeve e në Konferencën Ndërballkanike*”. Përmes këtij artikulli del qartë edhe mendimi mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Konferencave. Fillimisht trajtohet historiku i pjesëmarrjes së Shqipërisë në të tilla konferenca, që nga Lidhja e Kombeve dhe deri te përgatitjet për Konferencën Ballkanike në Athinë. Sipas këtij artikulli, pranohet se “*Shqipëria me Lidhjen e Kombeve e ka një dava të hapur*”<sup>21</sup>, duke sjellë dyshime në mbështetjen e ndërkombëtarëve evropianë. “Davaja e hapur” i referohet çështjes së pakicave shqiptare në Jugosllavi dhe Greqi, që ishin nën juridiksionin e Lidhjes së Kombeve, problemi i të cilave, sipas palës shqiptare, nuk ishte zgjidhur parimisht drejt. Mosbesimi që kishin krijuar shqiptarët ndaj

<sup>19</sup> AQSH, F.151, V.1930, D.103, fl.19-22. Shkresë nga “Bureau International de la Paix.

<sup>20</sup> “Kongresi pan-ballkanik i Athinës” në *Gazeta Shqipëtare*, 5 gusht 1930, f. 3.

<sup>21</sup> Namik Delvina, “Shqipëria pranë Lidhjes së Kombeve e në Konferencën Ballkanike” në *Arbënia*, Tiranë, nr.10, 26 gusht 1930, f.1. (Shënim: “dava” i referohet çështjes së pakicave etnike shqiptare në Greqi dhe Jugosllavi, problemi i të cilave duhej zgjidhur nga Lidhja e Kombeve).

Lidhjes së Kombeve rezikonte edhe reputacionin e Konferencës Ballkanike, e cila ende nuk ishte mbledhur. Po sipas të njëjtit artikull pohohet se “...Kur Shqipëria nuk gjen zgjidhje për një çështje vitale në Lidhjen e Kombeve, nuk e dimë se ç’do të gjejë përpara dërgata Shqiptare në Athinë.”.<sup>22</sup> Në fund artikulli mbyllet me një thirrje kushtuar autoriteteve dhe komisionit përfaqësues: “S’ka nevojë të jemi aspak të rezervuar, por duhet të jemi krejt të organizuar për të kërkuar të drejtat e vëllezërve tanë, në Athinë dhe Beograd... Ç’lidhje ballkanike mund të bëhet ndryshe, po nuk u siguria mbi të gjitha respekti dhe dinjiteti njerëzor?”<sup>23</sup> Ky qëndrim paraqet një paralelizëm mes zgjidhjes së çështjes çame (problem që u trajtua në Konferencën e Lozanës më 1923, dhe u nënshkrua në traktatin me të njëjtin emër, “Traktati i Lozanës”)<sup>24</sup>, dhe mbartjes së këtij problemi deri në periudhën e Konferencave Ballkanike. Nacionalizmi që shoqëron këtë artikull krijon idenë e mosbesimit në zgjidhjet që ofron Lidhja e Kombeve. Sipas saj në më shumë se një herë Lidhja e Kombeve kishte treguar që ishte e pafuqishme ndaj realizimit të të drejtave të shqiptarëve. Pesimizmi i retrospektivës vinte në dyshim çdo tentativë të ballkanasve për t’u integruar. Trajtesa e Konferencës në këtë aspekt e vinte në terren jo të favorshëm Shqipërinë, sipas nacionalistëve.<sup>25</sup>

Periudha shtator-nëntor është periudha më e ngjeshur me artikuj dhe mendime të shtypit, për faktin se Konferenca e Parë u mbajt më 5-12 tetor. Periudha para dhe pas mbajtjes së Konferencës përmban më tepër artikuj analizues, ndërsa opinionet dhe qëndrimet politike i gjejmë më tepër gjatë muajit të Konferencës së Parë Ballkanike. Kryesisht, artikujt e kësaj periudhe paraqesin të dhëna në lidhje me formimin e delegacionit, numrin e pjesëmarrësve, specialitetet e figurave që ishin pjesë e delegacionit dhe mendimet rreth tyre, aspekte të cilat trajtohen gjerësisht duke lënë të nënkuptuar se çdo detaj ka rëndësi.

Shtypi i viteve '30 në Shqipëri ka trajtuar edhe çështje të politikës së jashtme, aleatët e mundshëm të Shqipërisë dhe evidentimin e vendeve me interesa jo të njëjta. Në këtë kuadër, një ngjarje që shtoi intensitetin e shkrimeve me karakter politik në shtyp, ishte lajmi se Bullgaria nuk do të

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena 2009, f.340; *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll.III, f.599-506.

<sup>25</sup> “Shqipëria pranë Lidhjes së Kombeve” në *Arbënia*, nr.10, 26 gusht 1930.

merrte pjesë në Konferencë, për shkak të mospërputhjes së interesave të saj me përmbajtjen e programit të Konferencës. Në lidhje me këtë botuan pikëpamjet e tyre pothuajse të gjitha të përditshmet e datës 1 tetor 1930. Në të përditshmen “Ora” botohet qëndrimi i grupimeve brenda komisionit që do të përfaqësonte Shqipërinë në Konferencë. Pasi ishin informuar mbi mospjesëmarrjen e Bullgarisë në Konferencë, komisioni u nda në dy pjesë me mendime kontradiktore, duke vënë në dyshim edhe pjesëmarrjen e vetë Shqipërisë. Sipas artikullit, pasi ishin ftuar në shtëpinë e Mehmet Konicës për të biseduar, ishin krijuar dy rryma të ndryshme *“Ekstremistët që ishin për mos pjesëmarrje, pasi pjesëmarrja e tyre do të ishte e kotë, dhe pjesa tjetër, të moderuarit, që mendonin të mos kopjonin Bullgarinë pasi nuk ishte oportune”*.<sup>26</sup> Nuk jepet në artikull asnjë qëndrim mbi këto dy fraksione, duke ruajtur një ekuilibër mbi çështjen, pra larg qëndrimeve mbi njërin apo tjetrën palë. Mbi, po të njëjtin fakt, shkruan edhe gazeta “Vullneti i popullit”, por në ndryshim nga sa më lart, në artikullin me titull *“Dërgata Shqiptare për në Konferencën Ballkanike niset sot”* e përditshmja pohon, se gjatë diskutimeve në shtëpinë e Mehmet Konicës ju dërgua një telegram Z. Papanastasiu për t’i kërkuar shpjegime në lidhje me mungesën e delegacionit bullgar në Konferencë. Vetëm pasi kishte marrë përgjigjen e telegramit nga Athina, delegacioni vendosi të nisej për në shtetin helen.

Mjaft interesant në këtë artikull është fakti se delegacioni u takua edhe me Mbretin Zog përpara nisjes. Kështu, *“në audiencë përpara mbretit u propozua se përveç të tjerave, konferencën e dytë do të luteshin ta kishin në Tiranë”*.<sup>27</sup> Ky ishte një nga propozimet më të guximshme, i cili nuk u shqyrtua nga Asambleja e Konferencës dhe kështu Konferenca Ballkanike nuk u zhvillua asnjëherë në Tiranë.

Delegacioni u nis më 2 tetor 1930 pas telegramit të dërguar nga Leonidha Naçi, i cili përcillte një përshkrim mbi situatën e krijuar në shtetin helen<sup>28</sup>. Delegacioni ndoqi itinerarin e zakonshëm Tiranë, Korçë, Follorinë, Selanik, Athinë. Në përbërje të tij, siç dihet, ishin Mehmet Konica, At Gjergj Fishta, Imz. Jul Bonati, Maliq Bushati, Bedri Pejani,

<sup>26</sup> “Delegacioni Shqiptarë ndërroi mejtim me marrë pjesë në konferencën ballkanike” në *Ora*, Tiranë, nr.184, 1 tetor 1930, f.1.

<sup>27</sup> “Dërgata Shqiptare për konferencën ballkanike” në *Vullneti i popullit* nr.73, 2 tetor 1930, f.1.

<sup>28</sup> “Dërgata Shqiptare u nis dje pas një marrëveshje me Z. Papanastasiu” në *Arbënia*, nr.26, 3 tetor 1930, f.1.

Asim Jakova, Stavro Stavri, Leonidha Naçi, Faslli Frashëri, Seid Toptani dhe Znj. Emine Toptani. Të gjithë ishin intelektualë të njohur e specialistë në fushat e tyre.

Në lidhje me pritshmëritë që kishin për arritjet e Konferencës së Parë Ballkanike rrethet intelektuale në Shqipëri, do të shqyrtohen artikujt e gazetave “Vullneti i popullit” dhe “Ora”. Në të dy gazetat pranohet se pjesëmarrja e Shqipërisë ishte shumë pozitive, sepse “*Shqipëria nuk duhet të mungojë kurrë aty ku duhet të tregojë ekzistencën e saj si shtet dhe si komb*”.<sup>29</sup> Por ndihen dyshimet në qëndrimin e kësaj gazete kur thuhet se: “*me gjithë vullnetin e mirë të dërgatës tonë, besojmë se Z. Papanastasiu do ta kalojë me oratori dhe pa zgjidhje reale çështjen e minoriteteve*”.<sup>30</sup> Pra, parimisht në artikull nuk vihet në dyshim qëllimi i mirë i delegacionit shqiptar, por nuk besojnë në një qëndrim pozitiv të pjesëmarrësve grekë të Konferencës.

Përveç çështjes së minoriteteve dhe statusit të çdo vendi, si çështje shumë të diskutuar, shtypi ngrinte edhe një problem tjetër dhe mjaft të civilizuar për kohën, atë të mospërfaqësimit të gazetarëve vendas në këtë ngjarje. Në disa artikuj të gazetave formulohen thirrje ndaj qeverisë që të financojë gazetarë dhe reporterë për të ndjekur Konferencën. Për të shtuar vëmendjen mbi këtë çështje, në gazeta u botuan edhe ngjarje të tjera, në të cilat përfaqësuesit shqiptarë kishin triumfuar me fjalimet e tyre në mbrojtje të çështjes kombëtare, por për mungesë të reporterëve, ngjarjet ishin shtrembëruar nga shtypi i huaj.<sup>31</sup> Pra, duke qenë se Konferenca paraqiste vlera, në të duhej të kishte përfaqësues të shtypit shqiptar, jo vetëm për të informuar mbi veprimtaritë e delegacionit e të Konferencës, por edhe për të shmangur keqinformimet e opinionit në vend si pasojë e tendencave të shtypit të huaj.

Siç edhe u theksua më lart, çështja e minoriteteve u trajtua dhe u komentua në të gjitha të përditshmet në buletinet politike të tyre. “Ora” i kushtoi vëmendje fjalimeve që mbajtën përfaqësuesit e komisioneve të Greqisë, Turqisë dhe Jugosllavisë mbi minoritetet. Artikulli pohon se pati një përplasje mes dy grupeve të pjesëmarrësve në Konferencë mbi çështjen e minoriteteve. Përfaqësuesit shqiptarë dhe ato bullgarë pranuan rëndësinë e bisedimeve të hollësishme mbi pakicat,<sup>32</sup> por përballë

<sup>29</sup> “Konferenca Ballkanike” në *Vullneti i popullit*, nr. 147, 4 tetor 1930, f.2.

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> “Çështja e pakicave bisedohet parimisht” në *Ora*, 7 tetor 1930, f.1-4.

debateve me përfaqësuesit jugosllavë dhe grekë, të cilët mbanin qëndrime të ndryshme, u detyruan të pranonin “*që çështja e pakicave të bisedohet vetëm në parim.*”<sup>33</sup>

Në artikujt e të përditshmes “Vullneti i popullit” jo rrallë përfshihen edhe qëndrimet e ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, z. Pandeli Evangjeli, i cili përfaqësoi qëndrimin zyrtar mbi çështjen. Në të gjitha rastet e shkëmbimeve të telegrameve mes tij dhe përfaqësuesit grek, z. Papanastasiu, u dallua një analizë pozitive e përmbajtjes së telegramit duke mos e fshehur aspak simpatinë mbi këtë fakt. Në lidhje me minoritetet, në artikullin “Bisedime në Konferencat Ballkanike” u botuan të plota diskutimet e delegatëve mbi zgjidhjen e këtij problemi.<sup>34</sup> Në analogji me këtë aspekt u shqyrtua edhe domosdoshmëria e afrimit intelektual. Kjo ishte njëra nga çështjet që gjeti një mirëkuptim të gjerë në radhët e përfaqësuesve. Përmbajtja e këtij programi synoi që në të ardhmen tekstet shkollore të botoheshin me frymë solidariteti mes popujve ballkanikë. Gjithashtu shkëmbimi i vizitave mes studentëve, konferencat e përbashkëta e deri te propozimi më ambicioz me natyrë ekonomike, njëjtimin e monedhës në shtetet e Ballkanit<sup>35</sup>. Në afrimin intelektual, artikulli evidenton veprimtarinë e përfaqësuesit Faslli Frashëri, i cili vlerëson kulturën helene, në këtë rast, duke e krahasuar atë me djepin e civilizimit. Artikulli, edhe në mënyrën se si është formuluar, përcjell nota optimiste për realizimin e aspiratave sociale dhe kulturore të delegatëve shqiptarë.

Tematika e bashkëpunimit politik ishte mjaft e vështirë për t’u realizuar për shkak të kriterëve që vendosnin palët ndaj njëra – tjetrës. Situata në të cilën u përfshinë diplomatët, shqiptarë dhe jugosllavë mbi çështjen e pavarësisë apo “indipendencës” (çështja se si i interpretonin marrëdhëniet italo-shqiptare jugosllavët), shkaktoi reagime të shumta në shtyp. Në këtë rast, gazetat “Vullneti i popullit” dhe “Arbëria” kritikuan ashpër qeverinë për mosdërgimin e gazetarëve vendas për të informuar publikun shqiptar mbi ngjarjen. Në to, gjithashtu, mbahet një qëndrim mjaft nationalist. Mbi pohimin e përfaqësuesit jugosllav z. Topaloviç, gjatë punimeve të seksionit të çështjeve politike, se “*indipendenca*

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> “Bisedime në konferencën Ballkanike – diskutimi - Z. Kiroff , përfaqësues i Bullgarisë në lidhje me zgjidhjen e çështjes së minoriteteve” në *Vullneti i popullit*, nr.73, 8 tetor 1930, f.1-4.

<sup>35</sup> Po aty.

*Shqiptare është në rrezik*<sup>36</sup> duke nënkuptuar marrëveshjen italo-shqiptare, shtypi vendas shkroi mjaft artikuj polemizues. Jehonë në artikujt e shtypit në këtë rast i bëhet fjalimit dhe kundërpërgjigjes së Mehmet Konicës. Ai e mbrojti, sipas shtypit, shumë mirë çështjen e kombit të tij. Më tej kjo ide përforcohet me qëndrimet e shprehura, që shkojnë deri në dyshim mbi Konfederatën Ballkanike, si: “*pa u zgjidhur më parë konfliktet e zjarra dhe kryesore që ndodhen, është fare e kotë të bisedohet për një konfederatë*”<sup>37</sup> apo “*në ka rrezik më të madh në Ballkan, ky është rreziku i krijimit të shtetit Jugosllav*”<sup>38</sup>. Artikulli i referohet idesë së kahershme serbe për krijimin e një shteti federativ në Ballkan me qendër Serbinë. Gazeta “Ora” gjithashtu botoi fjalët e Konicës: “*Marrëveshja italo-shqiptare nuk do të kishte arsye ekzistence po të mos shkaktohej prej kërcënimeve nga jashtë.*”<sup>39</sup> Pothuajse në të gjitha të përditshmet që u botuan brenda vendit argumentet ishin nacionaliste, kur paraqitet rasti i problemeve të tilla. Pra, Shqipëria vetëm e shqiptarëve. Artikujt shfaqen përjashtues në lidhje me ndikimin italian në Shqipëri.

Ky qëndrim merr trajta më të plota kur, në gazetën “Rilindja e Arbërisë”, analizohet se si është transmetuar lajmi përtej kufirit, në Beograd. Sipas këtij organi shtypi, ishte zhvilluar një polemikë mes dy të përditshmeve zyrtare të Romës “Giornale d’Italia” dhe Beogradit “Politika” ku ishin hedhur akuza dhe kundëraakuza për sferat e influencës në Ballkan, specifikisht në Shqipëri. Sipas gazetës “Politika” e riprodhuar në “Rilindja e Arbërisë” “*Duhej përmendur sinqerisht nevoja e të gjitha shteteve ballkanike që Shqipëria të jetë tërësisht independente. Mendja e shqiptarëve duhet tu mbushet se ata mund ta sigurojnë independencën e tyre në bashkimin ballkanik. Mbrojtja e një fuqije tjetër të huaj, që ka qëllime kolonizimi nuk i u sjell lirinë, por robërinë.*”<sup>40</sup> Kjo ide u kundërshtua nga e përditshmja italiane, duke u shprehur se: “*Në të vërtetë*

<sup>36</sup> “Një fjalim i përfaqësuesit Jugosllav për pak do të shkaktonte shpërndarjen e konferencës” në *Vullneti i popullit*, nr. 150, 10 tetor 1930, f.1.

<sup>37</sup> “Mendime dhe përshtypje rreth konferencës ballkanike” në *Vullneti i popullit*, nr. 152, 12 tetor 1930, f.2.

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> “Delegati Jugosllav kërkoi ndjesë të nesërmen për atakimin e Shqipërisë” në *Ora*, 10 tetor 1930. (Shënim: Artikulli mban nënshkrimin se është telegram i dërguar posaçërisht për këtë të përditshme, f.4).

<sup>40</sup> “Fletorja serbe thotë se Italia ka qëllime kolonizimi në Shqipëri” në *Rilindja e Arbërisë*, Tiranë, nr.29, 11 tetor 1930, f.1.

“Politika”, që në emër të Serbisë dëshiron të duket si mbrojtëse e lirisë së Shqipërisë, nuk duhet të harrojmë jo vetëm që një milion shqiptarë jetojnë akoma nën zgjedhën e zotërimit serb, por edhe që qëndrimet e kufizimet më të mëdha kundra independencës së Shqipërisë kanë ardhë nga ana e Serbisë”.<sup>41</sup> Ky artikull i botuar në gazetë, pati për qëllim informimin e shoqërisë me qëndrimet e shtypit të huaj mbi çështjen shqiptare dhe, gjithashtu ripohoi edhe njëherë se natyra e aleancës mes Shqipërisë dhe Italisë ishte, sipas tyre, veçse mbrojtëse. Natyra e konfliktit mes Italisë dhe Jugosllavisë për Shqipërinë është e hershme dhe tejet strategjike. Ajo buron që me “Çështjen e Adriatikut”<sup>42</sup> d.m.th me përcaktimin e sferave të influencës së fuqive kryesore evropiane me synime në rajon.

Pas lajmit për krijimin dhe nisjen e delegacionit në Konferencë, ky ishte lajmi i dytë për të cilin u shkruajt dhe u komentua gjatë në shtypin brenda dhe jashtë vendit.

I njëjti lajm u botua edhe në Boston, atje ku komuniteti shqiptar e ndiqte me shumë vëmendje tërësinë e zhvillimeve në lidhje me Shqipërinë. Pohimit të z. Topaloviç se “Ato shtete që kanë aleancë militare me shtete të tjera evropiane duhet të përjashtohen nga konferenca”<sup>43</sup> i kundërpërgjigjet menjëherë shkrimi i Z. Stavro Stavri “Le të jeni i sigurt se Shqipëria do ta humbë lirinë e vet kur të mos egzistojnë më shqiptarët.”<sup>44</sup>

Në aspektin social, Konferenca e Parë Ballkanike i zhvilloi punimet edhe në sesionin e ekonomisë, postave dhe Kryqit të Kuq Ballkanik, ngjarje këto që nuk mbetën në hije të gazetarisë vendase. Interesante ishte ideja dhe funksionimi i Kryqit të Kuq. Referuesi jugosllav ishte dr. Nedelkoviç, i cili tregoi mënyrën e organizimit të shpërndarjes së ndihmave të Kryqit të Kuq, popullsive që vuajtën prej tërmeteve e fatkeqësive natyrore<sup>45</sup>, duke ndjekur shembullin jugosllav. Për këtë fakt, dr. Nedelkoviç u përshëndet nga përfaqësuesi i delegacionit shqiptar, i cili e vlerësoi këtë nismë humane.

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> *Historia e popullit Shqiptar*, vëll.III; Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Kristalina-KH, 2007, f.103.

<sup>43</sup> “Konferenca Ballkanike” në *Dielli*, Boston, nr.5204, 10 tetor 1930, f.1-4.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> “Hapja e të parës konferencë rezhjonale e Kryqit të Kuq të shteteve ballkanike” në *Vullneti i popullit*, nr.153, 12 tetor 1930, f.1.

Fjalimi i Mehmet Konicës në sesionin politik të Konferencës zë një vend të rëndësishëm. Gazeta “Arbënia” shkroi në faqen e parë të saj se delegacioni shqiptar u përfaqësua mirë në Athinë dhe se qëllimi i tij u përmbush nëpërmjet fjalimit të Z. Konica. Detyra e ngarkuar si kryetar i delegacionit e shfaqte atë shumë përgjegjës për idetë që do të përcillte. Ishte e qartë se në Konferencë duhej që vendet e tjera, sidomos Jugosllavia, të kuptonin pavarësinë e Shqipërisë nga Italia, si dhe të bindeshin në ekzistencën e problemit të minoriteteve mes Shqipërisë, Greqisë dhe vetë Jugosllavisë. Fjala e Konicës nis me shprehjen se *“Fakti që ne ndodhemi sot këtu është një provë e gjallë se popujt që përfaqësojmë nisin sot të hapin sytë dhe të mendojnë qartë mbi gabimet e kohës së shkuar. Evropianët e quajnë Ballkanin magazinën e barotit të Evropës, po harrojnë se ata vetë na e japin barotin. Po përmend tërë filozofin e historisë ballkanike, se prej një shekulli Ballkani është një lodër e influencave të Fuqive të Mëdha”*.<sup>46</sup> Artikulli i kushtoi rëndësi edhe fjalës së Z. La Fontaine, president i zyrës së Paqes. Ai theksoi: *“Bëjuni zotër të fatit t’uaj, kini si shenjën tuaj moton e atdheut tim Belgjikës: ‘në bashkim rron fuqia’ ”*<sup>47</sup>, si për t’i treguar të pranishmëve se është me vend që të lihen mënjandë për momentin çështjet që i ndajnë dhe të fokusohen në çështjet që i interesojnë e për të cilat nuk kanë konflikte. Me gjithë tonet nacionaliste fjala e Konicës, sipas shtypit, u prit mirë nga qarqet politike pjesëmarrëse, dhe sidomos nga populli shqiptar, i cili u informua përmes shtypit me publikimin e fjalimit të plotë.

Një analizë thellësisht politike i ka bërë kësaj ngjarjeje gazeta “Dielli” në artikullin *“Konferenca Ballkanike”*. Sipas shkrimit, kishte vend për dyshime të forta në lidhje me rezultatet e kësaj Konference. Vështrimi duhej hedhur përtej përfitimeve modeste ekonomike që mund të kishin disa kategori të caktuara shoqërore në Shqipëri. Politikanët që u dërguan në Konferencë, duhej ta kishin kuptuar këtë situatë sepse sipas artikullit: *“Franca po përpiqej që të ngrinte gracka kundra Italisë në Ballkan, dhe mendojmë se diçka fshihet pas kësaj. Franca dhe Jugosllavia sot janë të lidhura kundra Italisë, dhe po përpiqen me çdo mënyrë të prishin miqësinë e Italisë me çdo shtet tjetër të Ballkanit”*.<sup>48</sup> Kjo trajtë e interpretimit nuk gjendet në këtë periudhë në shtypin vendas.

<sup>46</sup> “Shqipëria përfaqësohet mirë në Athinë, fjala e Mehmet Konicës bën bujë” në *Arbënia*, nr.30, 14 tetor 1930, f.1.

<sup>47</sup> Po aty.

<sup>48</sup> “Konferenca ballkanike” në *Dielli*, 14 tetor 1930, f.2.

Arsyet lidhen me faktin se kjo gazetë botohet jashtë Shqipërisë, pra jashtë influencave të politikës vendase. Artikulli vazhdon më tej me tone të ashpra: “E dimë të gjithë se sa ja duan shëndetin Shqipërisë, Jugosllavia me Greqinë, të cilat janë munduar ta copëtojnë edhe atë copë vend të lirë që ja lanë Fuqitë e Mëdha Shqipërisë. Nëse duan vërtetë të punojnë për Ballkanin, duhet të lëshojnë më parë pjesët që kanë zaptuar me forcë nga Shqipëria dhe Bullgaria”.<sup>49</sup> Në atë periudhë qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ishte vendimtar në përcaktimin e orientimit që do të kishin nismat rajonale. Fuqitë evropiane, për shkak të pozicionit të tyre dominues dhe potencial në ekonomi, herë pas here kanë ndërhyrë në mënyrë të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë në vendimmarrje, në shtete të caktuara ballkanikë.

“Gazeta e Korçës” në artikullin “Kryetarët e dërgatave të kënaqur nga përfundimet”<sup>50</sup> botoi të gjitha mendimet e kryetarëve të delegacioneve në lidhje me arritjet e Konferencës. Artikulli pohoi, ndër të tjera, se mendimet e Z. Pella, përfaqësues i Rumanisë, Z. Hasan Beu, përfaqësues i Turqisë, Z. Janko Sakizov, zëvendëskryetar i Bullgarisë, Z. Vilibor Joniç, përfaqësues i Jugosllavisë, ishin tërësisht pozitive sa i takoi arritjeve. Ata pranuan se ishin këto çështje që i mbanin të ndara vendet e Ballkanit, por që përmes zyrtarizimit të kësaj organizate do të arriheshin rezultate akoma më të mira për të gjitha vendet. Duke filluar nga ky numër i “Gazetës së Korçës” e në vazhdim, në shumë gazeta të tjera filloi të shtohet ndjeshëm numri i artikujve me tematikë rreth Konferencës Ballkanike. Një rëndësi të veçantë gazetave i kushtuan publikimit të mendimeve që kishte shtypit i huaj mbi këtë Konferencë. Pra, shpesh gjejmë pjesë të shkëputura të shtypit jugosllav, italian, francez,<sup>51</sup> të cilat janë mendime por edhe kundërpërgjigje të njëra-tjetrës, të botuara në faqet e gazetave brenda vendit. Bashkë me mendimet dhe interpretimet mbi shtypin e huaj, gazetave gjetën rastin të kritikojnë periodikisht qeverinë për indiferencën e saj në lidhje me përfaqësimin e shtypit vendas në Konferencë.

<sup>49</sup> Po aty.

<sup>50</sup> “Kryetarët e dërgatave të kënaqur nga përfundimet” në *Gazeta e Korçës*, Korçë, nr. 1093, 17 tetor 1930, f.1-4.

<sup>51</sup> “Komentet e shtypit të huaj mbi punët e Konferencës Ballkanike” në *Gazeta e Korçës*, nr. 1093, 17 tetor 1930, f.4. (Shënim: Artikulli boton mendime të gazetës “Le temps” nga Parisi dhe “Tevere” nga Italia).

“Demokratia” e riktheu edhe një herë në artikullin e saj “Indipendenca Shqiptare, në thembër të paqes” çështjen e incidentit mes delegacionit jugosllav dhe atij shqiptar gjatë sesionit politik të mbledhjes. Për të rirforcuar edhe një herë idenë se Shqipëria është e pavarur, analizon se çështja, sipas saj, është keqpërdorimi nga ana e delegatit jugosllav i “traktatit të miqësisë” ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë të nënshkruar kohë më parë. Pavarësisht se një ditë më vonë delegati jugosllav kërkoi ndjesë për këtë shprehje, sipas “Demokratia” ky ishte një qëndrim i hapur politik ndaj Shqipërisë. Kundërpërgjigjja e artikullit të gazetës ishte radikale: *“Kemi bërë një lidhje me Italinë ashtu siç ka të drejtë të bëjë edhe çdo shtet tjetër independent. Ashtu siç kanë bërë dikur edhe Portugalia e Belgjika me Anglinë. Këtë gjë e din fare mirë Jugosllavia, por nuk e thotë, sepse përmes saj shohin goditjen e përvdekëshme të shikimeve të tyre zaptanjëse”*.<sup>52</sup> Më pas, me rastin e zgjedhjes së tij si kryetar nderi i Konferencës Ballkanike, bëhet një përmbledhje e shkurtër e të gjithë veprimtarisë, fjalimeve të delegatëve, si dhe një biografi e shkurtër e Z. Pandeli Evangjeli, i cili ishte njëkohësisht edhe kryeministër i vendit.

Një nga ngjarjet më të publikuara në shtypin e kohës ka qenë edhe fjalimi i Mehmet Konicës. Në vazhdimësi gazeta “Vullneti i popullit”<sup>53</sup> publikoi artikuj mbi mendimet e Konicës në Konferencën Ballkanike. Fjalimi i Mehmet Konicës dhe mendimi i tij mbi marrëdhëniet shqiptarogreke, apo historikun e tyre që nga lashtësia, e parë në këndvështrimin e kësaj gazete, duken mjaft optimiste. *“Greqia edhe Shqipëria, mund të shërbejnë si udhëheqës dhe shembull për afrimin e popujve ballkanikë, po të mos ishin aq të ngadalshëm. Afërsitë tona, raca, zakonet tona, mentaliteti ynë, mënyra jonë e të menduarit, janë aq të ngjashëm. Simpatia midis dy popujve tonë ka rrënjë aq të thella dhe mosmarrëveshjet janë të vogla sa që do mjaftonte vetëm një hap për tu afruar njëri me tjetrin”*.<sup>54</sup> Po kështu, në mbrojtje të idesë pozitive mbi Konferencën Ballkanike, Konica pohoi: *“Suksesi i bashkimit ballkanik*

<sup>52</sup> “Indipendenca Shqiptare, në thembër të paqes” në *Demokratia*, Gjirokastrë, nr. 272, 18 tetor 1930, f.1.

<sup>53</sup> *Gazeta Vullneti i popullit*, nr.159, 160, 161, 162, 163, 164, datë: 19, 20, 21, 22, 23, 24 tetor 1930.

<sup>54</sup> “Fjalimi i Z. Mehmet Konicës në darkën zyrtare që dha qeveria Greke për nderim të kongresistëve të konferencës ballkanike” në *Vullneti i Popullit*, nr. 159, 19 tetor 1930, f.1.

varet gati nga atituda e Jugosllavisë”.<sup>55</sup> Pas përballjes me situatën edhe vetë Konica në mënyrë të tërthortë pohoi se në Konferencë ndikimin më të madh e kishte Jugosllavia dhe Greqia. Përmes një analize historike nuk është e vështirë të pohojmë se marrëdhëniet me fqinjët jugosllavë dhe grekë nuk kanë qenë të mira, ndaj dhe arritjet e bashkëpunimi ishin të largëta, pa u zgjidhur çështja e minoriteteve.

Optimizmi i Konicës shprehet edhe në një intervistë të tij në gazetën “Ora”, ku pranon se *“ishte i bindur mbi suksesin, sigurisht nëse çështja e pakicave do të gjente zgjidhje të mirë dhe të arsyeshme.”*<sup>56</sup> Për të forcuar akoma më shumë qëndrimin e saj, e përditshmja “Ora”, të nesërmen botoi fjalimin e plotë të Z. Papanastasiu, ku qëllimi final i fjalimit ishte të bënte me dije se *“asgjë nuk mund të na ndalojë që të vijojmë rrugën e re që shënuam...”*<sup>57</sup>

Në buletin politik të të përjavshmes “Demokratia” u trajtua çështja e minoriteteve duke iu referuar teorisë së Briandit dhe tentativës së tij për të bashkuar evropianët. Kështu, mes rreshtave theksohet se *“në Evropë janë dy korente, njeri ka për qendër Francën edhe kërkon të respektohen shtetet siç u formuan pas luftës, tjetri korent ka për qendër Italinë e cila kërkon të ndryshohet gjendja e shteteve dhe të modifikohen kufijtë e tyre. Ndërmjet këtyre korenteve vepron diplomacia, e cila nuk po arrin të gjejë një zgjidhje të pranueshme përgjithësisht”*.<sup>58</sup> Formulues i këtij qëndrimi ishte gazetari Jorgji Meksi, i cili rimori edhe disa herë të tjera në shqyrtim këto fakte.

Periodha nëntor-dhjetor e vitit 1930 përmban disa artikuj me refleksione rreth së kaluarës dhe së ardhmes së Ballkanit dhe ndikimin e Konferencës Ballkanike në çështje me karakter politik mes vendeve. “Vullneti i popullit” boton një artikull i cili arsyeton mbi disa lëvizje të vendeve pjesëmarrëse në Konferencë, në formën e vizitave diplomatike, pasi Konferenca kishte përfunduar. Kështu, sipas artikullit, kur nuk kishte shumë kohë që kishte përfunduar Konferenca Ballkanike, në të cilën kishte marrë pjesë edhe Shqipëria *“Tani po konstatojmë një lëvizje tjetër në këto vise që me të drejtë janë quajtur shkëndia e Evropës. Kryeministri Z. Venizellos dhe ministri i punëve të jashtme, Z.*

<sup>55</sup> “Përfundimet e konferencës ballkanike, Z. Mehmet Konitza deklarohet optimist” në *Arbënia*, nr.36, 22 tetor 1930, f.2.

<sup>56</sup> “Përpyekjet e dërgatës Shqiptare” në *Ora*, 21 tetor 1930, f.1.

<sup>57</sup> “Mesazhi i konferencës ballkanike” në *Ora*, 22 tetor 1930, f.4.

<sup>58</sup> “Çështja e pakicave” në *Demokratia*, nr.273, 27 tetor 1930, f.1.

*Mihalakopulos, u nisën për në kryeqytetin e Turqisë*<sup>59</sup>. Përpara se të nisej, Z. Mihalakopulos i bëri shtypit të tij vendas këtë deklaratë të shkurtër: “*Historia pesëqindvjeçare e konflikteve të përgjakëshme midis Turqisë dhe Greqisë u mbyll në një herë e mirë*”.<sup>60</sup> Po sipas të njëjtës së përditshme, për në Angorë u nis dhe kryeministri i Hungarisë, konti Bethlen, i cili i deklaroi shtypit se “*pranoi me kënaqësi ftesën e qeverisë Turke jo vetëm pse dëshiron të njohë nga afër reformat moderne të krijuara nga Turqia e re*”<sup>61</sup>, duke lënë të nënkuptohej edhe ndonjë lëvizje tjetër diplomatike, me këtë rast. Ai theksoi gjithashtu se kjo vizitë do t’i jepte rastin të bisedonte me burrat e shtetit të Angoras mbi problemet ekonomike të dy vendeve.<sup>62</sup> Këto lëvizje diplomatike filluan të komentoheshin dhe trajtoheshin me dyshim në shtypin shqiptar. Kombinacionet e shteteve nuk ishin në favorin e Shqipërisë, sipas shtypit, dhe ajo që nisi me dyshim në Konferencë ka gjasa të kthehet në realitet. Traktatet apo aleancat dypalëshe brenda formacioneve të mëdha, siç ishte edhe ideja e Unionit Ballkanik, nuk ishin aspak premtuese.

Në këndvështrimin social e trajtoi çështjen edhe artikulli i “Demokratia-s” ku përmes një analize në buletin politik, kërkoi të rendisë arsyet sociale të bashkëpunimit mes vendeve. Në Konferencën e Parë Ballkanike pjesëmarrësit u mbështetën në faktorin psikologjik<sup>63</sup>, në ndjenjat si dashuria, miqësia me të cilat mund të sigurohej afrimi paraprak mes vendeve. Përveç kësaj, edhe përdorimi i një gjuhe të përbashkët do të ishte shumë frytdhënës e për këtë mendohej se mes gjuhëve angleze, gjermane, italiane dhe frënge kjo e fundit do të ishte më e pranueshme për të qenë gjuhë zyrtare në vendet e konfederatës ballkanike.

Gjatë muajit dhjetor shtypi i kushtoi rëndësi dy çështjeve të tjera me karakter social që qenë pjesë e programit të Konferencës së Parë Ballkanike. Së pari, krijimi i organizatës së grave<sup>64</sup> dhe së dyti, krijimi i shoqatës së shtypit<sup>65</sup>. Këto organizata të shoqërisë civile do të përfaqësonin kategoritë e tyre sociale. Trajtesa e tyre në shtyp tregoi

<sup>59</sup> “Rreth Ballkanit” në *Vullneti i popullit*, nr. 178, 6 nëntor 1930, f.1.

<sup>60</sup> Po aty.

<sup>61</sup> Po aty.

<sup>62</sup> Po aty.

<sup>63</sup> “Konferenca ballkanike” në *Demokratia*, nr. 274, 24 tetor 1930, f.1-4.

<sup>64</sup> “Gruaja Shqiptare përfaqësohet në konferencën e Athinës” në *Gazeta shqiptare*, nr. 9, 1 dhjetor 1930, f.2.

<sup>65</sup> “Shoqata e shtypit të ballkanëve, statuti i saj” në *Arbëria*, 17 dhjetor 1930, f. 3.

rëndësinë e femrës në shoqërinë shqiptare dhe të shtypit në emancipimin e mëtejshëm mbarëshoqëror.

Pasqyrimi i ngjarjeve të Konferencës së Parë Ballkanike në shtyp evidentoi emancipimin e shoqërisë shqiptare dhe socializimin e saj me ngjarje të natyrës politike ndërkombëtare. Duke e konsideruar Shqipërinë e viteve '30 të përfshirë në krizën ekonomike botërore edhe shtypi i kushtoi rëndësi aspekteve bashkëpunuese të fushës ekonomike, sociale dhe intelektuale. Përjashtimi në përgjithësi i trajtimit të aspektit politik të këtij evenimenti jep hapësira për përfundime, si: shtypi me gjithë subjektivitetin që e karakterizon, pasi ai shpreh interesat e grupeve të ndryshme apo e forcave të ndryshme politike, edhe gjate viteve '30, përpiqet të jetë realist. Trajtimi i Konferencës në aspektin politik krijoi një terren të vështirë bashkëpunimi për të gjitha vendet pjesëmarrëse. Shpërqendrimi i vëmendjes, por jo domosdoshmërisht zhdukja e trajtimit të problemit etnik dhe i çështjes së minoriteteve, u konsiderua si një përpjekje pozitive fillestare që do të çonte në përfshirjen e Shqipërisë në organizatat e ndryshme të Konferencës Ballkanike dhe më pas që aty do të bëhej zgjidhja e problemit politik.

Shtypi i viteve '30, sidomos ai brenda vendit, ishte përgjithësisht i ndikuar nga qeveria e Mbretit Zog e për këtë arsye mendoj është anashkaluar pikërisht pasqyrimi i problemeve që rrjedhin nga çështja e minoriteteve, duke e përqendruar vëmendjen e shtypit, rrjedhimisht dhe të shoqërisë, tek aspekti social dhe intelektual. Një nga arsyet më themelore të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e Parë Ballkanike, ishte kriza e madhe ekonomike dhe acarimi i marrëdhënieve me Italinë. Në atë periudhë, sipas historiografisë vendase, pothuajse çdo sektor i ekonomisë shqiptare ishte plotësisht ose pjesërisht në administrimin e specialistëve italianë<sup>66</sup>. Shtypi në këtë pikë ka anashkaluar, për arsye politike, trajtimin e një problemi të tillë pasi kështu, duke u shfaqur publikisht gjendja mes Shqipërisë dhe Italisë, komprometohej edhe më tej pozita e Shqipërisë në raport me vendet pjesëmarrëse në Konferencë, sidomos me Jugosllavinë, megjithëse në Shqipëri në fillim të viteve '30 kishte nisur të thellohej një ndjenjë antiitaliane në shoqëri.<sup>67</sup>

<sup>66</sup> Iliaz Fishta, *Ndërrhyrje e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruese për Shqipërinë*, Tiranë: 8 Nëntori, 1989, f.18-27.

<sup>67</sup> Miranda Vickers, *The Albanians*, London: I.B.Tauris 2011, f.132.

Qëndrimi i shtypit shqiptar në periudhën qershor-dhjetor 1930 në lidhje me Konferencën Ballkanike ka qenë i orientuar në dy drejtime.

*Së pari*, një pjesë e organeve të shtypit përmes artikujve të publikuar janë shprehur mjaft mosbesues e madje kanë shprehur edhe doza të larta pesimizmi në lidhje me Konferencën Ballkanike. Këto gazeta, duke iu referuar kushteve në të cilat u ideua dhe më pas u organizua Konferenca Ballkanike, nuk e fshehën mosbesimin e tyre në lidhje me rezultatet. Të tilla qëndrime e nisin arsyetimin që në origjinën e hershme të ngjarjeve të pazgjdhura nga të tjera organizata ndërkombëtare si Lidhja e Kombeve. Çështjet për të cilat shtypi shprehet mosbesues janë: çështja e minoriteteve dhe çështja e ruajtjes së tërësisë territoriale e institucionale. Artikujt në lidhje me këto çështje nuk janë polemizues, përkundrazi, kanë të njëjtin arsyetim logjik. Gazetat, si: “Arbënia” apo “Vullneti i popullit” e më pas “Demokratia”, e trajtuan këtë argument atëherë kur filloi Konferenca dhe jo më parë. Gjatë gjithë kësaj periudhe analiza mbi çështjen e minoriteteve në këto gazeta ka të njëjtën trajtë. Pra, trajtën e një mosbesimi në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ekziston edhe një fakt tjetër të cilin gazetat e përmendin shumë pak, gati në mospërfillje, trajtimin e Shqipërisë si një aleate të Italisë. Kjo e dëmtoi mjaft imazhin e Shqipërisë, por shtypi nuk e përdori këtë argument për të justifikuar joefektivitetin e Konferencës. Duke qenë se pjesa më e madhe e gazetave vendase janë të ndikuara nga politika e Mbretit Zog, vërehet dukshëm trajtimi i kësaj çështjeje në një tjetër këndvështrim. Në përgjithësi, dominojnë artikujt të cilët evidentojnë vështirësitë e mëdha të këtij bashkëpunimi panballkanik. Një aspekt tjetër që tregon mosbesim në shtypin e kohës është ngjyrimi jozyrtar që i dedikohet delegacionit dhe vetë Konferencës. Shpesh në shtyp, kur pritshmëritë nuk ishin në përputhje me arritjet, përdorej termi “jo zyrtarë” për t’i zhveshur nga detyrimet delegatët dhe qeverinë.

*Së dyti*, janë ato artikujt nëpër gazeta të cilat përtej dyshimeve shohin fusha të reja bashkëpunimi. Ato më tepër i referohen dëshirës së madhe të shqiptarëve për bashkëpunim me vendet e Ballkanit, në kushtet e fillimit të përkeqësimit të marrëdhënieve me Italinë, dhe fillimit të krizës së madhe ekonomike botërore (1929-1933). Pavarësisht se në asnjë artikull nuk u përmend gjendja e vështirë ekonomike, kjo shërbeu si faktor vendimtar në gjetjen e hapësirave të reja bashkëpunuese nga ana e qeverisë shqiptare. Impenjimi i qarqeve intelektuale për të krijuar strukturat analoge ishte i dukshëm e për këtë shtypi shkroi mjaft artikuj

inkurajues në lidhje me krijimin e organizatës së shtypit ballkanik, organizatës së gruas, organizatës ekonomike etj. Këto nisma konkrete janë tepër domethënëse, pavarësisht se sa ato funksionuan në realitet. Përgjithësisht, pra, shtypi ka treguar vëmendje të veçantë në lidhje me Konferencën Ballkanike. Përmes tij është informuar shoqëria shqiptare dhe diaspora. Qëndrimet e shtypit, megjithëse janë subjektive, përcjellin mendimin e kohës në lidhje me qëllimin, organizimin, dhe pritshmëritë e Konferencës së Parë Ballkanike.

### *S u m m a r y*

#### THE ATTITUDE OF ALBANIAN PRESS TOWARD FIRST BALKAN CONFERENCE

A part of the press through their published articles have expressed great disbelief and even high notes of pessimism regarding the Balkanic Conference. These newspapers, referring to the conditions in which the conference was organized didn't hide their disbelief regarding the results. These attitudes were reasoned since the early origin of the unsolved events from other organizations like the League of Nations. The issues that the press expressed his disbelief were the minorities issue and the issue of keeping the integrity of territories and institutions. The articles in these papers were not polemic, on the contrary they have the same logic reasoning. Newspapers like "Arbenia" or "Vullneti i popullit" and afterwards "Demokracia" treated this argument when the Conference began and not sooner. All this time the analysis on the minority issue followed the same line, the line of disbelief regarding the solving of this issue. There is another fact which the press almost ignores or speaks very little of, the treatment of Albania as an ally of Italy. This damaged the image of Albania, but the press didn't use this fact to justify the lack of effectiveness of the Conference. Considering that the press was highly influenced by the politics of King Zog, it is noted the treatment of this issue from another angle. In general the most common articles are the ones who evidence the great difficulties of this panbalkan cooperation. Another aspect that shows disbelief in the press is the non official colorment dedicated to the delegation and the Conference itself. Often in the press, when the expectations were in complete match with the accomplishments, it uses the term "non official" to relieve delegates and the government from their obligations.